



REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES
**SHTABI I PËRGJITHSHËM
I FORCAVE TË ARMATOSURA
QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT**



**AGJENCISË KOMBËTARE TË
PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Nr. 3423/2 Prot.

Nr. 1456 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur sot më datë 11 /06 /2024, në Tiranë, ndërmjet:

QENDRËS SË PERSONEL REKRUTIMIT përfaqësuar nga Kolonel Fadil Ciroku, Komandant, me adresë “Rruga e Dibrës”, AL-100, Tiranë, Shqipëri, këtu e në vijim të quajtur QPR;

dhe

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE, përfaqësuar nga Z. Klevis HYSA, Drejtor i Përgjithshëm, me adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, 1004, Tiranë-Shqipëri, këtu e në vijim e quajtur AKPA;

Individualisht referuar si **PALË** dhe bashkërisht referuar si **PALËT**, synojnë:

- Të bashkëpunojnë për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit.
- Bashkëpunimin ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Drejtorive Rajonale në qarqe me Qendrën e Personel Rekrutimit (QPR) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) dhe strukturat e vartësisë në qarqe për evidentimin e punëkërkesve, në mënyrë të veçantë të të rinjve dhe të rejave të moshës deri në 30 vjeç.
- Sigurimin e ndërsjellë të informacionit për mbajtjen dhe përditësimin e listës së punëkërkesve që mund të punësohen/rekrutohen në Forcat e Armatosura apo të rekrutuarit në Forcat e Armatosura nga radhët e listave të punëkërkesve të AKPA, duke respektuar kërkesat e Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.



- Palët angazhohen për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, në respektim të akteve të njohura ligjore që rregullojnë përcaktimin e formës së mbështetjes, kriteret dhe kushtet për përfitimin e mbështetjes, duke rënë dakord si vijon:

NENI 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj marrëveshje është vendosja e bashkëpunimit ndërmjet Palëve, të cilat konsistojnë në shkëmbimin e informacionit të ndërsjellë për evidentimin e punëkërkuësve, përditësimin e të dhënave të tyre duke respektuar kërkesat e Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

NENI 2 BAZA LIGJORE

Marrëveshja bazohet në ligjin nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; ligjin nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ndryshuar; ligjin nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"; ligjin nr. 15/2017 "Për arsimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 554/2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 628/2019 "Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë" si dhe në Vendimin nr. 867/2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", i ndryshuar.

NENI 3 ANGAZHIMET E PALËVE

3.1 Palët marrin përsipër:

Palët angazhohen për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, mbi bazën e parimit të reciprocitetit duke rënë dakord si më poshtë:

- Të përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje, për të shkëmbyer informacione të ndërsjella për evidentimin e punëkërkuësve kryesisht të moshave të reja deri në 30 vjeç, përditësimin e të dhënave të tyre si dhe masa organizative për punësim/ rekrutim në Forcat e Armatosura
- Të programojnë takime periodike për shkëmbim informacioni lidhur me detyrimet ligjore dhe bashkëpunimin e përbashkët për përmirësimin e procedurave që vlerësohen për të ardhmen;
- Të gjejnë dhe vlerësojnë forma të ndryshme bashkëpunimi, sidomos me drejtoritë rajonale të punësimit në qarket dhe në Forcat e Armatosura.



- d. Të respektojnë kërkesat e Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

3.2 Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive merr përsipër:

- a) Që nëpërmjet institucioneve të varësisë, drejtorive rajonale në qarqe, etj., të vendosë në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, nëpërmjet strukturës vartëse, Qendrës Personel Rekrutimit dhe seksioneve të saj në qarqe kandidatët e dakordësuar të punëkërkuesve të moshave deri në 30 vjeç, me qëllim punësimin/rekrutimin në Forcat e Armatosura.
- b) Nëpërmjet drejtorive rajonale në qarqe, të sigurojnë bashkëpunimin institucional për shtetasit që regjistrohen si punëkërkues, kryesisht të moshave të reja deri në 30 vjeç, me qëllim që Qendra e Personel Rekrutimit të kontaktoj për përzgjedhje për rekrutim në Forcat e Armatosura nga kandidatët e dakordësuar.
- c) Nëpërmjet strukturave përkatëse vartëse, drejtorive rajonale në qarqe, njofton ndryshimet në lidhje me punëkërkuesit, adresat, si dhe të dhëna tjera të tyre sipas kërkesës së Qendrës Personel Rekrutimit, duke respektuar kërkesat e Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

3.3 Qendra e Personel Rekrutimit merr përsipër:

- a) Nëpërmjet strukturave të vartësisë së saj në qarqe të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacione për të dhënat e punëkërkuesve që administrojnë AKPA, me qëllim punësimin/rekrutimin e tyre në Forcat e Armatosura.
- b) Nëpërmjet strukturave të vartësisë së saj në qarqe të administrojnë dhe të përditësojnë listën e të rinjve/rejave punëkërkues me qëllim që të komunikohet për mundësitë që ofrojnë për punësim/rekrutim në Forcat e Armatosura.
- c) Nëpërmjet strukturave të vartësisë së saj në qarqe të mbajë dhe zbatojë procedura standarde për kandidatët e dakordësuar të të rinjve punëkërkues në drejtoritë rajonale të punësimit, duke respektuar kërkesat e Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

NENI 4 KOMUNIKIMI

- a) Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e angazhimeve të tyre, sipas kësaj marrëveshje. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe/ose nëpërmjet postës elektronike.
- b) Secila palë do të caktojë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të marrëveshjes. Personat e kontaktit do të jenë të disponueshëm për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve.



A large, stylized handwritten signature in black ink.

NENI 5
NDRYSHIME

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellë me shkrim të palëve.

Ndryshimet hyjnë në fuqi pas nënshkrimit përkatës nga palët.

NENI 6
KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

- a) Kjo marrëveshje lidhet pa një afat të caktuar dhe secila nga palët ka të drejtën të përfundojë në çdo kohë marrëveshjen me një njoftim me shkrim drejtuar palës tjetër 30 (tridhjetë) ditë përpara.
- b) Përfundimi i kësaj marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor, pas marrjes së njoftimit me shkrim nga pala tjetër.

NENI 7
HYRJA NË FUQI

Marrëveshja e bashkëpunimit hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve. Ajo përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, nga 2 (dy) për secilën palë.

Për

**QENDRËN E PERSONEL REKRUTIMIT
SHPFA**

**Kolonel Fadil CIBOBU
KOMANDANT**



Për

**AGJENCINË KOMBËTARE TË
PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**Klevis HYSA
DREJTORI PËRGJITHSHËM**

